




OLOF PALME
INTERNATIONAL
CENTER



HARTA E BARRIERAVE

MALISHEVË



DHJETOR 2018



Ky publikim u realizua ne kuader te projektit "Qytetet Gjithëpërfshirëse" - promovimi dhe përhapja e metodologjisë së planifikimit urban me pjesëmarrje" përkrahur financiarisht nga Olof Palme International Center, që përkrahet nga Qeveria e Suedisë

Botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren

**Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, 10000/
Prishtinë**

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

029-222-771 & 038-224-967

HARTA E BARRIERAVE

për qasjen dhe lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara në Malishevë

**Autore e hulumtimit:
Flaka Xërxa Beqiri**

**Asistentë në hulumtimin e realizuar në terren:
Patriot Paqarizi dhe Valon Xhabali**

Maj, 2018

PËRMBAJTJA

1. Përshkrimi dhe metodologjia e hulumtimit

1.1 Qëllimi i hulumtimit

1.2 Përshkrimi i metodologjisë

1.3 Përcaktimi i parametrave të identifikimit të barrierave bazuar në legjislacionin në fuqi

2. Identifikimi i barrierave në lëvizje dhe në qasje në qytezën e Malishevës

2.1. Përshkrimi i trajektores së analizuar

2.2. Përshkrimi i objekteve të analizuara

2.3. Identifikimi i barrierave të përgjithshme në lëvizje të PAK

2.4. Identifikimi i pikave kritike të cilat paraqesin barriera në lëvizje të PAK - Harta e përgjithshme e barrierave

2.5. Identifikimi i barrierave në qasje dhe shfrytëzim të objekteve të analizuara - Barrierat në objektet publike të Malishevës

3. Rekomandimet

3.1. Rekomandime të përgjithshme lidhur me eliminimin e barrierave në qasje dhe në lëvizje në qytezën e Malishevës

3.2. Rekomandimet për eliminimin e barrierave në qytezën e Malishevës - Harta e përgjithshme

3.3. Rekomandimet për eliminimin e barrierave në objektet publike të qytezës së Malishevës - Harta e objekteve

4. Referencat

PAK - Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë individët që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale ose shqisore afatgjata të cilat në ndërveprim me pengesa të ndryshme mund ta pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në mënyrë të barabartë me të tjerët.

**bazuar në definicionin e Konventës mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Kombet e Bashkuara*

1. Përshkrimi dhe metodologjia e hulumtimit

1.1 Qëllimi i hulumtimit

Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK) kushtimisht vazhdojnë të jenë të kategorizuar në rradhën e grupeve të marginalizuara. Edhe pse Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara e Kombeve të Bashkuara siguron gëzimin e plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga të gjithë personat me aftësi të kufizuara, komuniteti PAK në vendin tonë rrezulton të jetë i privuar nga e drejta themelore, ajo e të qenurit i barabartë.

Veçanërisht liria e lëvizjes vazhdon të jetë nocion i harruar për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë. Barrierat fizike dhe mungesa e infrastrukturës së përshtatshme për të gjitha kategoritë e këtij komuniteti, vazhdon të jetë e shprehur në të gjitha komunat e Kosovës. Kushtet jo të favorshme për lëvizje të pavarur dhe pengesat në qasje në objektet publike vërehen në masë të madhe edhe në Malishevë, edhe pse kjo komunë është njëra ndër pesë më të mëdhatë në rajonin e Prizrenit.

Përkundër gjendjes jo të mirë të reflektuar nga të dhënat nga terreni në qytetet më të mëdha e edhe qytezat në vend, baza legjislative e Republikës së Kosovës flet për një realitet tjetër. *Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023, Ligji për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar, Nr. 2003/23, Ligji për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuar, Nr. 03/L-019, Ligji për Personat e Verbër Nr.04/L-092, Udhëzimi Administrativ nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara* fasin për një bazë të fuqishme ligjore në favor të përmirësimit të kushteve për personat me aftësi të kufizuara.

Më konkretisht Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023, që paraqet një dokument të rëndësishëm dhe që ka për mision krijimin e politikave më të qëndrueshme në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, ka në fokus qështjen e qasjes si shumë të rëndësishme për përmirësimin e gjendjes aktuale sa i takon personave me aftësi të kufizuara në Kosovë. Madje qasja si dhe pjesëmarrja dhe përfshirja e plotë dhe efektive e PAK në shoqëri bën pjesë në rradhën e tetë parimeve kryesore të strategjisë nacionale. Me qasje të plotë kjo strategji nënkupton shërbimet, ambientet dhe produktet të cilat janë të qasshme dhe të shfrytëzueshme nga të gjithë personat me aftësi të kufizuar.

Prioritizimi i qështjes së qasjes dhe pjesëmarrjes së PAK vërehet edhe në përfshirjen e tyre në një ndër objektivat e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023. Objektiva nr.5 e kesaj strategjie synon krijimin e kushteve të barabarta në qasje, informim, komunikim dhe pjesë-

marrje në mënyrë që ky komunitet të ketë qasje të barabartë me të tjerët në ambientet fizike, transport, informata dhe teknologji e sisteme informative. Kjo objektivë strategjike bazohet në hulumtimet paraprake të cilat tregojnë se ekzistojnë pengesa të mëdha në vendin tonë të cilat u pamundësojnë personave me aftësi të kufizuara që të integrohen në mënyrë të barabartë në shoqëri. Ndër pengesat të cilat listohen në strategjinë nacionale janë: barrierat strukturore në objektet e ndërtuara, mungesa në planifikim urbanistik, enterieret e planifikuara gabimisht etj.

Të gjitha kufizimet të cilat vazhdojnë të jenë të pranishme në rrethanat infrastrukturore të vendit tonë, bëjnë që aktualisht personat me aftësi të kufizuara të jenë të përjashtuar nga jeta politike, publike, sociale, kulturore e sportive. Ata janë të privuar nga e drejta për jetë të pavarur dhe pjesëmarrje të plotë qytetare, e drejtë kjo e garantuar përmes Konventës së Kombeve të Bashkuara dhe Ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës.

Duke patur parasysh këtë problem madhor lidhur me gëzimin e të drejtave substanciale nga PAK, ky hulumtim synon që të bëjë dokumentimin e pengesave të cilat limitojnë personat me aftësi të kufizuara në qasjen dhe lëvizjen e tyre të barabartë me qytetarët tjerë. Pas publikimit të Hartës së Barrierave për qytetin e Prizrenit, EC vazhdon praktikimin e metodologjisë së njejtë në evidentimin e pengesave kryesore në qytezën e Malishevës, duke synuar vazhdimin e prodhimit të dokumentit të njejtë edhe për njësitë tjera territoriale të Kosovës.

Qëllimi i këtij hulumtimi është që duke bërë evidentimin e pengesave në lëvizje dhe qasje në hapësirat dhe objektet publike nga ana e personave me aftësi të kufizuara në qytezën e Malishevës, të ipen rekomandime konkrete lidhur me intervenimet e nevojshme që duhet të ndërmiren nga ana e organeve përkatëse, më konkretisht nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, në mënyrë që PAK të gëzojnë të drejtat themelore në raport me qytetin.

1.2 Përshkrimi i metodologjisë

Duke synuar identifikimin e barrierave të cilat pamundësojnë lëvizjen dhe qasjen në hapësira dhe objekte publike të qytezës së Malishevës, ky hulumtim ka për bazë bazën ligjore në fuqi, me theks në Udhëzimin Administrativ nr. 33/2007 për Kushtet Tenike të Objekteve Ndërtimore si dhe të dhënat nga terreni.

Normat minimale të përcajtuara me ligjet në fuqi janë listuar (më gjerësisht në parametrat e përgjithshme) dhe janë marrë në konsideratë gjatë hulumtimit në terren. Parametrat e përgjithshëm janë konceptuar në mënyrë që të plotësojnë nevojat e të gjitha kategorive të personave me aftësi të kufizuara, duke rradhitur këtu personat me aftësi të kufizuara në lëvizje (përdorues të mjeteve ndihmëse lëvizëse), në shikim, në dëgjim dhe të folur dhe aftësinë e kufizuar intelektuale.

Përcaktimi i parametrave në fjalë si dhe shqyrtimi i hulumtimeve që i takojnë këtij fushëveprimi, i kanë paraprirë përcaktimit të metodologjisë së identifikimit të barrierave në terren.

Paraprakisht është bërë analiza e lokacionit të gjerë të qytezës së Malishevës, duke shqyrtuar shtrirjen urbane, hapësirat publike kryesore, objektet publike kryesore dhe rrugët të cilat mund të jenë më të frekuentuara nga personat me aftësi të kufizuara. Më pas nga ekipi punues është bërë identifikimi në terren i pikave dhe trajektoreve të cilat pamundësojnë lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara, duke u bazuar në kërkesat e tyre varësisht se cilës kategori i takojnë. Në ekipin hulumtues në terren është përfshirë edhe një person me aftësi të kufizuar motorike, përdorues i karrocës mekanike, duke qenë se barrierat fizike janë nga pengesat më të shprehura në këtë qytezë, përjashtuar këtu faktin se Malisheva nuk ofron aspak kushte për lëvizje dhe qasje të personave me aftësi të kufizuara në shikim dhe dëgjim.



Hulumtimi në terren është realizuara ndarazi duke analizuar:

- 1. Lëvizjen e lirë të personave me aftësi të kufizuara - PAK në zonën urbane duke përfshirë rrugët kryesore, parqet, hapësirat përreth objekteve publike dhe hapësirat tjera publike*
- 2. Qasjen në objektet publike dhe (pa)mundësinë e shfrytëzimit të tyre nga ana e personave me aftësi të kufizuara - PAK*

Rrjedhimisht ky hulumtim paracakton barrierat në zonën e ngushtë urbane të qytezës së Malishevës të evidentuar në hartën e barrierave. Pos hartës së barrierave, hulumtimi shpalos problemet në qasje dhe shfrytëzim të objekteve kryesore publike, duke përfshirë: Objektin e Komunës së Malishevës, Objektin e Postës, Stacionin e Autobusëve, Objektin e Policisë, Objektin e Administratës Publike, Biblotekën, Shkollën Fillore "Ibrahim Mazreku", Shkollën e Mesme - Gjimnazin "Hamdi Berisha", Qendrën Kryesore të Mjeksisë Familjare, Qendrën për Punë Sociale dhe Objektin e KEDS.

Pas hulumtimit dhe mbledhjes së të dhënave nga terreni, është bërë krahasimi i tyre me dispozitën ligjore dhe parametrat e paracaktuar nga ligjet në fuqi. Rrjedhimisht ky dokument përfundon me rekomandimet konkrete lidhur me eliminimin e barrierave ekzistuese në përshtatshmëri me normat minimale të ligjeve në fuqi.


1.3 Përcaktimi i parametrave të identifikimit të barrierave bazuar në legjislacionin në fuqi

Identifikimi i barrierave gjatë analizës në terren është bërë duke marrë parasysh normativat e paracaktuar në legjistraturën në fuqi, përkatësisht në Udhëzimin Administrativ për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara. Përmes këtij Udhëzimi Administrativ synohet rregullimi i kushteve teknike në mënyrë që personat me aftësi të kufizuar të kenë qasje, lëvizje dhe qëndrim/shfrytëzim të objekteve pa u penguar dhe pa u limituar. Dokumenti në fuqi jep rekomandime të përgjithshme si dhe të profilizuara për lloje të ndryshme të objekteve, mirëpo për nevoja të këtij hulumtimi janë përzgjedhur ato rekomandime të cilat aplikohen për hapësirat publike dhe objektet publike. Rrjedhimisht, bazuar në këtë prioritizim të rekomandimeve të cilat do të mund të krijonin një pasqyrë reale të gjendjes në qytezën e analizuar, janë përcaktuar parimet kryesore në bazë të të cilave është bërë identifikimi i barrierave në qasje dhe në lëvizje.

Bazuar në dokumentin në fjalë, gjatë hulumtimit në terren janë dokumentuar pengesat të cilat ndikojnë në shfrytëzimin e hapësirave në fjalë nga ana e PAK. Rrjedhimisht fushëveprimet të cilat janë analizuar bazuar në Udhëzimin Administrativ në fjalë janë:


1. ELEMENTET PËR QASJE NË KOMUNIKACION NË PUBLIK
2. KUSHTET PËR PËRDORIMIN E MJETEVE NDIHMËSE
3. ELEMENTET OBLIGATIVE PËR QASJE
4. ELEMENTET QASËSE PËR JETË TË PAVARUR

Faktorët e lartpërmendur janë analizuar në hapësirat publike dhe objektet e shqyrtuara, përmes metodologjisë së provës - ecjes me personat me aftësi të kufizuar, majtes dhe inqizimit, plotësimin të kartelave të objekteve dhe identifikimit të problemeve në hartën e qytezës. Lidhur me lëvizjen e lirë në zonën urbane dhe përshtatshmërinë e rrugëve, komunikacionit dhe hapësirave publike për PAK, janë analizuar: prania ose jo e vendparkingjeve të dedikuara për PAK, shtigjet për këmbësorë të dizajnuara ose jo për të gjitha kategoritë e PAK, përshtatshmëria në lëvizje në vendkalimet e këmbësorëve, përshtatshmëria e lëvizjes në ishullin e këmbësorëve si dhe dizajni ose jo i udhëkryqeve dhe semaforëve për nevojat e PAK. Ndërsa analizat në objektet e përfshira në këtë analizë është bërë në shqyrtim të plotësimin ose jo të parametrave të shkëputur nga UD për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e PAK.




ELEMENTET PËR QASJE NË KOMUNIKACIONIN PUBLIK - SHTEGU PËR KËMBËSOR

- aplikohet te personat me shikim të dobësuar dhe të verbër (shfrytëzues të shkopit dhe qenit ndihmës)
- gjerësia minimale e shtegut për lëvizje 150 cm
- dysheme me materializim të njëtrajtshëm dhe pa pengesa në lëvizje
- e ngitur nga guri skajor kufizues 3 cm
- rrethoja sigurie deri në 90 cm në kufizim me komunikacionin e dendur




ELEMENTET PËR QASJE NË KOMUNIKACIONIN PUBLIK - VENDKALIMI I KËMBËSORËVE

- aplikohet te të gjitha kategoritë e PAK
- gjerësia minimale e shtegut për lëvizje 120 cm (e pastër) e siguruar me gurin skajor
- dysheme me materializim të njëtrajtshëm, pa pengesë në lëvizje
- sipërfaqe taktore udhëheqëse
- guri skajor me sipërfaqe taktore paralajmëruese te hapësira për kalim, në pjerrësi maksimale 10 %




ELEMENTET PËR QASJE NË KOMUNIKACIONIN PUBLIK - ISHULLI PËR KËMBËSORË

- aplikohet te të gjitha kategoritë e PAK
- sipërfaqja taktore paralajmëruese në fillim dhe në përfundim të rrugës me gjerësi 15 cm
- sipërfaqe taktore orientuese në gjerësi 40 cm në drejtim të rrugës përcjellëse
- sipërfaqja taktore paralajmëruese në pjerrësi maksimale 10 %




ELEMENTET PËR QASJE NË KOMUNIKACIONIN PUBLIK - UDHËKRYQI

- aplikohet te të gjitha kategoritë e PAK
- sipërfaqja taktore paralajmëruese në fillim dhe në përfundim të rrugës me gjerësi 15 cm
- sipërfaqe taktore orientuese në gjerësi 110 cm në drejtim të ndërrimit të kahjes së rrugës
- sipërfaqja taktore paralajmëruese në pjerrësi maksimale 10 %
- semafor sinjalizues zanor për personat e verbër dhe me shikim të dobësuar, i arritshëm për personat në karrocë




ELEMENTET PËR QASJE NË KOMUNIKACIONIN PUBLIK - VENDPARKINGU

- aplikohet te p.shfrytëzues të karrocës
- sipërfaqe e cila nuk pengon lëvizjen e karrocës (rërës, zhavorit, gjelbërimit etj)
- të vendosura në varg, pjerrtas apo në gjatësi, me dimensione 220 X 500
- sip. e lirë në mes të dy parkingjieve 150 cm
- të lidhura me shtegun e këmbësorëve me rampë / gurit skajor 10 %





KUSHTET PËR PËRDORIMIN E MJETEVE NDIHMËSE - HAPËSIRA E NEVOJSHME PËR LËVIZJE ME KARROCË

- ⊙ aplikohet te personat shfrytëzues të karrocës
- ⊙ gjerësia e nevojshme në hapësirat e brendshme 90 cm
- ⊙ gjerësia e nevojshme në hapësirat e jashtme 120 cm
- ⊙ diametri i nevojshëm i lirë për rrotullim 150 cm





KUSHTET PËR PËRDORIMIN E MJETEVE NDIHMËSE - HAPËSIRA E NEVOJSHME PËR PËRDORIMIN E SHKOPIT, PATERICËS, MJETIT NDIHMËS PËR ECJE

- ⊙ aplikohet te personat shfrytëzues të mjeteve ndihmëse për ecje
- ⊙ gjerësia e nevojshme e shtegut për shfrytëzim të shkopit 70 cm
- ⊙ gjerësia e nevojshme për shfrytëzim të patericës 90-120 cm
- ⊙ gjerësia e nevojshme për shfrytëzim të shtegut 70 cm



KUSHTET PËR PËRDORIMIN E MJETEVE NDIHMËSE - HAPËSIRA E NEVOJSHME PËR PËRDORIMIN E SHKOPIT TË BARDHË DHE QENIT ORIENTUES

- ⊙ aplikohet te personat e verbër - shfrytëzues të shkopit të bardhë dhe qenit orientues
- ⊙ gjerësia e nevojshme e shtegut për shfrytëzim 80 cm
- ⊙ gjerësia e nevojshme orientuese para personit në lëvizje 90 - 150
- ⊙ rrezja e shfrytëzimit të shkopit të bardhë 60 cm



ELEMENTET OBLIGATIVE PËR QASJE - PLLAKAT TAKTORE


- ⊙ aplikohet te personat me shikim të dobësuar dhe të verbër
- ⊙ struktura e pllakave taktore mund të jetë me luge apo me thepa
- ⊙ thellësia e pllakave taktore jo më shumë se 0.5 cm



Struktura me luge




Struktura me thepa




ELEMENTET OBLIGATIVE PËR QASJE - RAMPA

- ⊙ aplikohet te personat shfrytëzues të karrocës, shkopit dhe shoqëruesit e fëmijëve me karrocë
- ⊙ pjerrësia e lejuar 1:20 (5%)
- ⊙ gjerësia e nevojshme në hapësirat e brendshme 90 cm
- ⊙ gjerësia e nevojshme në hapësirat e jashtme 120 cm
- ⊙ në çdo 6 m largësi duhet të aplikohet pushimorja me gjerësi 150 cm
- ⊙ e realizuar ashtu që të mos jetë e ndjeshme në kushtet klimatike




ELEMENTET OBLIGATIVE PËR QASJE - DOREZA PERCJELLËSE NË RAMPË

- ⊙ aplikohet te personat shfrytëzues të karrocës, shkopit, shkopit të bardhë dhe të gjithë personat shfrytëzues të rampës
- ⊙ dorezë me diametër 4 cm
- ⊙ e vendosur në dy lartësi të ndryshme 60 cm dhe 90 cm, duke krijuar 'oazë' mbajtëse
- ⊙ e pa ndryshueshme në kushte termike
- ⊙ e paisur me shenjë paralajmëruese për qasje




ELEMENTET OBLIGATIVE PËR QASJE - SHKALLËT

- ⊙ aplikohet te personat me shikim të dobësuar, personat e verbër shfrytëzues të shkopit të bardhë dhe qenil orientues
- ⊙ lartësia e nevojshme e shkëlësës 15 cm
- ⊙ gjerësia e nevojshme e shkëlësës 33 cm
- ⊙ gjerësi drite të hapit të shkallës në hapësira të mbyllura 110 cm;
- ⊙ gjerësi drite të hapit të shkallës në hapësira të jashtme 120 cm;
- ⊙ përfundim me kontrast i shkëlësës dhe krahut të shkallëve
- ⊙ dorez mbajtëse e zgjeruar 30 cm




ELEMENTET QASËSE PËR JETË TË PAVARUR - HAPËSIRA HYRËSE

- ⊙ aplikohet te të gjitha kategoritë e PAK
- ⊙ derë njëkrihëshe 110x220 ose dykrihëshe 2x90x220
- ⊙ hapësirë drite 90 cm
- ⊙ derë hyrëse me prag jo më të lartë se 2 cm
- ⊙ pllaka faktore orientuese për komunikim
- ⊙ instalime elektrike të përshtatura për shfrytëzim nga PAK




ELEMENTET QASËSE PËR JETË TË PAVARUR - DOREZA

- aplikohet te personat shfrytëzues të karrocës
- të jetë e materialit jo të vrazhdë
- të jetë praktike në përdorim
- te dyert lartësia maksimale për vendosje është 80 cm
- te dritaret lartësia e nevojshme për vendosje është 90 - 120 cm




ELEMENTET OBLIGATIVE PËR QASJE - ASHENSORI

- aplikohet te të gjitha kategoritë e PAK
- në hapësirat e brendshme dhe të jashtme, me lartësi më të madhe se 120 cm
- dimensionet optimale 110 x 140
- gjerësia minimale e derës 90 cm
- pllakë drejtuese dhe lajmëruese në lartësi 90 - 120 cm, e paisur me pulla kontraste me mbishkrim në alfabetin e Braille
- paralajmërues zanor në ndalesat në kate
- i paisur me mbajtëse
- pllaka orientuese taktore me gjerësi minimum 40 cm nga hyrja në objekt deri te ashensori




ELEMENTET OBLIGATIVE PËR QASJE - PLATFORMA VERTIKALE NGRITËSE

- aplikohet te personat shfrytëzues të karrocës
- në hapësirat e brendshme dhe të jashtme, me lartësi më të madhe se 120 cm, ku nuk aplikohet ashensori, ose element qasës tjetër
- dimensionet optimale 110 x 140
- platforma boshtore anësore të mbyllura me gjerësi 120 cm
- gjerësia minimale e derës 90 cm
- derë që hapet jashtë apo derë rrëshqitëse
- e paisur me shenjë paralajmëruese për qasje




ELEMENTET OBLIGATIVE PËR QASJE - PLATFORMA E PJERRËT NGRITËSE PALOSËSE

- aplikohet te personat shfrytëzues të karrocës
- vendoset në murin anësorë të shkallëve apo në rrethojën e shkallëve
- sipërfaqja minimale qasëse 90 x 120
- mbrotjtëse anësore palosëse të dyshemesë 20 cm
- dorezë ndihmëse e cila paloset
- e paisur me shenjë paralajmëruese për qasje




ELEMENTET QASËSE PËR JETË TË PAVARUR - KOMUNIKIMI

- ⊙ aplikohet te të gjitha kategoritë e PAK
- ⊙ gjerësia e nevojshme më së paku 150 cm
- ⊙ sipërfaqe komunikimi në të njetin nivel dhe pa pengesa
- ⊙ derë me hapësirë drite 90 cm
- ⊙ derë me prag jo më të lartë se 2 cm
- ⊙ doreza sipas UD
- ⊙ instalime elektrike sipas përshtatshmërisë për PAK
- ⊙ shenjat për qasje të vendosura përgjatë hapësirës komunikuese




ELEMENTET QASËSE PËR JETË TË PAVARUR - WC

- ⊙ aplikohet te personat shfrytëzues të karrocës
- ⊙ derë hyrëse me gjerësi drite 90 cm
- ⊙ hapësirë lëvizëse për rrotullim në diametër 150 cm
- ⊙ guacë me dërrasë për ulje në lartësi 45 - 50 cm
- ⊙ mbajtëse në te dy anët e guacës me gjatësi 90 cm, të vendosura 80 - 90 cm në largësi nga dyshemeja
- ⊙ lavaman konzollë së paku 50 cm, të vendosur në lartësi 80 cm
- ⊙ instalime sipas nevojave të PAK, përfshirë alarmin për ndihmë



ELEMENTET QASËSE PËR JETË TË PAVARUR - KLASA

- ⊙ aplikohet te personat shfrytëzues të karrocës
- ⊙ gjerësia e nevojshme e shtegut për lëvizje në diametër 150 cm
- ⊙ gjerësia e nevojshme për lëvizje në mes të mobiliarit 120 cm
- ⊙ derë me hapësirë drite 90 cm
- ⊙ bankë konzollë me lartësi jo më të madhe se 85 cm



ELEMENTET QASËSE PËR JETË TË PAVARUR - SPORTELI

- ⊙ aplikohet te të gjitha kategoritë e PAK
- ⊙ për personat e verbër: pllaka taktore udhëheqëse deri në sipërfaqen shërbyese të sportelit
- ⊙ për personat në karrocë: sportel konzollë me lartësi maksimale 80 cm, thellësi për qasje më së paku në 50 cm, hapësirë për rrotullim në diametër 150 cm
- ⊙ për persona e shurdhër: asistencë në komunikim përmes mjeteve ndihmëse

2. Identifikimi i barrierave në lëvizje dhe në qasje në qytezën e Malishevës

2.1. Përshkrimi i trajektores së analizuar

Komuna dhe (me të njejtin emër) qyteza e Malishevës shtrihet në zonën qendrore të territorit të Republikës së Kosovës. Sipas të dhënave të Census të vitit 2011, qyteza arrin numrin të banorëve prej 3 395 banorë, ndërsa Komuna në tërësi ka 54 613 banorë.


E rrethuar me 43 fshatra përreth, qyteza e Malishevës luan rolin e qendrës administrative të Komunës së Malishevës, me të gjitha përmbajtjet e një njësie të tillë. Këtu përfshihen objektet publike kryesore, si objekti i komunës, shkollat fillore dhe e mesme, qendra e mjeksisë familjare, objektet për shërbime administrative komunale, njësia e policisë etj.

Gjendja infrastrukturore e Komunës së Malishevës në tërësi konsiderohet e mirë, marr parasysh se shumica e fshatrave janë të lidhura me rrjet rrugorë dhe kanë qasje në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit. Sidoqoftë këtotribute nuk mund të konsiderohen të mjaftueshme, sidomos kur marrim në konsideratë se vet qyteza e Malishevës ka ngecje në zhvillimin e indit urban me komponentet esenciale për të gjitha kategoritë e komunitetit, me theks në lëvizjen dhe qasjen e PAK. Ky hulumtim fokusohet në analizën e trajektores së indit urban, në funksion të përshtatshmërisë infrastrukturore për personat me aftësi të kufizuara.



Përcaktimi për trajektoren në bazë të të cilës është bërë analiza e pengesave në lëvizje dhe qasje për personat me aftësi të kufizuara është bërë në bazë të shtrirjes së indit urban. Trajektorja e analizuar shtrihet në boshtin veri-jug (përgjatë rrugës "Rilindja Kombëtare"), me zgjerim në pjesën lindore dhe perëndimore të indit urban. Përgjatë saj zhvillohen objektet kryesore publike, objektet e banimit individual dhe ato shumëbanesore si dhe në masë të madhe objektet afariste. Duke perimetruar këto objekte me rëndësi për shfrytëzimin ditor nga ana e qytetarëve, kjo trajektore

përbën hapësirën fizike më të frekuentuar nga ana e qytetarëve të qytezës së Malishevës, por jo edhe nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Këta indikatorë, shfrytëzimi i madh nga ana e qytetarëve në përgjithësi dhe mungesa e shfrytëzimit nga ana e PAK në veçanti, janë të mjaftueshëm në përcaktimin e kësaj trajektoreje për analizën e barrierave në qasje dhe në lëvizje.



2.2. Përshkrimi i objekteve të analizuar

Përpos analizës së barrierave në lëvizje në rrugët dhe hapësirat publike, është bërë edhe analiza e objekteve kryesore publike në qytezën e Malishevës, marrë për bazë pengesat e PAK në raport me shfrytëzimin e tyre. Në objektet e përzgjedhura për analizë, bazuar në metodën e krahasueshmërisë, është bërë analiza e elementeve të cilat përkujnë ose jo me kërkesat e paracaktuara nga Udhëzimi Administrativ për Kushtet Teknike të Objekteve

Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara. Rrjedhimisht për secilin objekt të përfshirë në këtë analizë, është bërë identifikimi i barrierave në qasje dhe në shfrytëzim si dhe identifikimi i elementeve të cilat do të duhej të shtoheshin si përmbajtje në mënyrë që të ndikonin në pavarsinë e shfrytëzimit të të këtyre objekteve nga personat me aftësi të kufizuara.



Objektet të cilat janë përfshirë në kuadër të kësaj analize janë: 1. & 2. Komuna e Malishevës, 3. Gjakata Komunale, 4. Banka, 5. Posta, 6. Stacioni i autobusëve, 7. Administrata Publike, 8. Stacioni Policorë, 9. Shkolla Fillore "Ibrahim Mazreku", 10. Shkolla e Mesme – Gjimnazi "Hamdi Berisha", 11. Qendra Kryesore e Mjeksisë Familjare, 12. KEDS - Distrikti në Malishevë, 13. Qendra për Punë Sociale, 14. Bibloteka Komunale

Për objektet e analizuar është hartuar kartela informuese lidhur me gjendjen ekzistuese dhe barrierat e identifikuara si dhe është bërë listimi i elementeve të cilat mungojnë e që do të duhej të ishin sipas UD. Për një analizë të tillë është bërë matja dhe inqizimi i elementeve të caktuara në kuadër të objekteve publike, përfshirë këtu: qasjen deri në objekt, hollin hyrës, komunikimin horizontal dhe vertikal, toaletet, shenjëzimin dhe praninë e parkingjeve për PAK.

2.3. Identifikimi i barrierave të përgjithshme në lëvizje të PAK

Gjatë analizës në terren përgjatë trajektorës së përshkruar është vërejtur që qyteza e Malishevës nuk tregon aspak përshtatshmëri për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara, përfshirë këtu të gjitha kategoritë. Përpos elementeve konkrete të cilat paraqesin barrierë për lëvizjen e lirë të PAK, të përshkruara në Hartën e Përgjithshme të Barrierave, ky hulumtim vë në pah disa probleme të përgjithshme të cilat paraqiten përgjatë tërë trajektorës.

Këtu mund të listohen:

ELEMENTE EKZISTUESE, JO-ADEKUATE

1. MUNGESA E PJERRINAVE NË VENDLKALIME



2. MATERIALIZIMI JO I DËHUR DHE I DËMTUAR NË SHTIGJET E KËMBËSORËVE



3. DIS-NIVELIMET PËRGJATË SHTIGJEVE TË KËMBËSORËVE



4. PRANIA E PENGESAVE FIZIKE PËRGJATË SHTIGJEVE TË KËMBËSORËVE



ELEMENTE QË MUNGOJNË

A. MUNGESA NË TËRËSI E PLLAKAVE TAKTORE



B. MUNGESA E PJERRINAVE



C. MUNGESA E SEMAFORËVE DHE VENDKALIMEVE PËR PAK




D. MUNGESA E VEND - PARKINGJEVE TË REZERVUARA PËR PAK



HARTA E PËRQJITHSHME E BARRIERAVE - MALISHEVË



 RRJETI RRUGOR
 OBJEKTE
 TROTUARE / HAPËSIRA PUBLIKE
 ● BARRIERA NË QASJE DHE LËVIZJE



 A ndryshim materializimi, sipërfaqe jo e rrafshët, dërra rrethuese - pengesë në hyrje të parkut...
 B materializim jo i duhur dhe i dëmtuar, sipërfaqe jo e rrafshët
 C trotuar i lartë, mungesë e plakave taktore, vendkallim jo-adekuat
 D trotuar i lartë, mungesë e plakave taktore, vendkallim jo-adekuat
 E trotuar i lartë, pengesë në qasje në park dhe në vendparkime
 F mungesë e parkingjeve të dekluar për PAK
 G plato e ngritur, pengesë në qasje dhe shfrytëzim nga PAK
 H mobiluar urban jo i përshatshëm për PAK
 I mungesë e plakave orientuese, mungesë e mobiluar urban të përshatshëm për PAK
 J trotuar i lartë, pengesë fizike, mungesë e plakave taktore, vendkallim jo-adekuat
 K trotuar i lartë, mungesë e plakave taktore, vendkallim jo-adekuat
 L ndryshim materializimi, sipërfaqe jo e rrafshët, dërra rrethuese - pengesë në hyrje të parkut

BARRIERAT NË OBJEKTET PUBLIKE TË MALISHEVËS

KOMUNA E MALISHEVËS - 01



barriera fizike ekzistuese

- 1 qasje e vështirë nga shtegu për këmbësorë në objekt
- 2 pjerrinë > 1:20
- 3 gjerësia e shkelëses së shkallëve më e vogël se 33 cm
- 4 lartësia e shkelëses së shkallëve më e madhe se 15 cm
- 5 de-nivelim në kuadër të hollit hyrës
- 6 toalete të papërshtatshme për PAK
- 7 sportel i papërshtatshëm për PAK
- 8 mungesë e elementeve për qasje në nivelet tjera të objektit
- 9 hapja e derës së hyrjes në anën e brendshme

elemente që mungojnë

- 1 parkungu i dedikuar për PAK
- 2 fushat dhe vijat udhëheqëse taktore
- 3 ndryshim-theksimi i skajit të shkelëses së shkallëve
- 3 rrethoja e pjerrinës
- 4 dorëza mbajtëse e shkallëve me krah më të gjerë se 250 cm
- 5 ashensori apo mjet tjetër që siguron qasjen për PAK në lartësi mbi 120 cm
- 6 shenjëzimi i hapjes së derës
- 7 shenjëzimi i qasjes së shkallëve
- 8 toaleti i dedikuar për PAK
- 9 sporteli i dedikuar për PAK



BARRIERAT NË OBJEKTET PUBLIKE TË MALISHEVËS

KOMUNA E MALISHEVËS - 02



barriera fizike ekzistuese

- 1 qasje e vështirë nga shtegu për këmbësorë në objekt
- 2 pjerrinë > 1:20
- 3 gjerësia e shkelëses së shkallëve më e vogël se 33 cm
- 4 lartësia e shkelëses së shkallëve më e madhe se 15 cm
- 5 pragu i derës më i lartë se 2 cm
- 6 toalete të papërshtatshme për PAK
- 7 sportel i papërshtatshëm për PAK
- 8 mungesë e elementeve për qasje në nivelet tjera të objektit
- 9 hapja e derës së hyrjes në anën e brendshme

elemente që mungojnë

- 1 parkungu i dedikuar për PAK fushat dhe vijat udhëheqëse taktore
- 2 ndryshim-theksimi i skajit të shkelëses së shkallëve
- 3 rrethoja e pjerrinës
- 4 dorëza mbajtëse e shkallëve me krah më të gjërë se 250 cm
- 5 ashensori apo mjet tjetër që siguron qasjen për PAK në lartësi mbi 120 cm
- 6 shenjzimi i hapjes së derës
- 7 shenjzimi i qasjes së shkallëve
- toaleti i dedikuar për PAK
- sporteli i dedikuar për PAK



BARRIERAT NË OBJEKTET PUBLIKE TË MALISHEVËS

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
DEGA MALISHEVË



barriera fizike ekzistuese

- 1 qasje e vështirë nga shtegu për këmbësorë në objekt
- 2 pjerrinë > 1:20
- 3 dorezë e pjerrinës jo-adekuate
- 4 gjerësia e shkelëses së shkallëve më e vogël se 33 cm
- 5 lartësia e shkelëses së shkallëve më e madhe se 15 cm
- 6 toaleta për PAK jo funksional - i mbyllur
- 7 sportel i papërshtatshëm për PAK (për të personat e verbër dhe të shurdhër)
- 8 sportel i papërshtatshëm për PAK
- 9 mungesë e elementeve për qasje në nivelet tjera të objektit

elemente që mungojnë

- 1 parkungu i dedikuar për PAK
- 2 fushat dhe vijat udhëheqëse taktore
- 3 ndryshim-theksimi i skajit të shkelëses së shkallëve
- 4 rrethoja e pjerrinës jo sipas standardeve të UD
- 5 gardhi anësor i shkallëve sipas standardeve
- 6 dorëza mbajtëse e shkallëve me krah më të gjerë se 250 cm
- 7 ashensori apo mjet tjetër që siguron qasjen për PAK në lartësi mbi 120 cm
- 8 shenjzimi i hapjes së derës
- 9 shenjzimi i qasjes së shkallëve
- 10 sporteli i dedikuar për të gjitha kategoritë e PAK



BARRIERAT NË OBJEKTET PUBLIKE TË MALISHEVËS

BANKA

**Klient i së cilës është personi me aftësi të kufizuara i përfshirë në këtë hulumtim*



barriera fizike ekzistuese

- 1 qasje e vështirë nga shtegu për këmbësorë në objekt
- 2 shkallë jo të përshtatshme për PAK - me pengesa në shikim
- 3 pragu i derës më i lartë se 2 cm
- 4 de-nivelim në pllato të hyrëse
- 5 mungesë e toaleteve për pak PAK
- 6 sportel i papërshtatshëm për PAK
- 7 hapja e derës së hyrjes në anën e brendshme

elemente që mungojnë

- parkingu i dedikuar për PAK
- fushat dhe vijat udhëheqëse taktore
- pjerrina për qasje në objekt
- 1 ndryshim-theksimi i skajit të shkelëses së shkallëve
- 2 dorëza mbajtëse e shkallëve me krah më të gjerë se 250 cm
- 3 shenjzimi i hapjes së derës
- toaleti i dedikuar për PAK
- 4 sporteli i dedikuar për PAK



BARRIERAT NË OBJEKTET PUBLIKE TË MALISHEVËS

POSTA DHE TELEKOMI I KOSOVËS-DEGA MALISHEVË



barriera fizike ekzistuese

- 1 qasje e vështirë nga shtegu për këmbësorë në objekt
- 2 de-nivelim në pllantonë hyrëse
- 3 pragu i derës më i lartë se 2 cm
- 4 mungesë e toaleteve për PAK
- 5 sportel i papërshtatshëm për PAK
- 5 hapja e derës së hyrjes në anën e brendshme


elemente që mungojnë

- parkingu i dedikuar për PAK
- fushat dhe vijat udhëheqëse taktore
- pjerrina për qasje në objekt
- 1 shenjëzimi i hapjes së derës
- toaleti i dedikuar për PAK
- 2 sporteli i dedikuar për PAK



BARRIERAT NË OBJEKTET PUBLIKE TË MALISHEVËS

STACIONI I AUTOBUSËVE - MALISHEVË



barriera fizike ekzistuese

- 1 qasje e vështirë nga shtegu për këmbësorë në objekt
- 2 qasje e vështirë në hapësirën rrethuese publike
- 3 de-nivelim në pllantonë hyrëse
- pragu i derës më i lartë se 2 cm
- toaletë të papërshtatshme për PAK
- 4 sportel i papërshtatshëm për PAK
- 5 hapja e derës së hyrjes në anën e brendshme
- 6 gur skajor i ngritur për qasje në autobusë

elemente që mungojnë

- parkingu i dedikuar për PAK
- fushat dhe vijat udhëheqëse taktore
- 1 ndryshim-theksimi i skajit dyshemesë - gurit skajor ku ka de-nivelime
- pjerrina për qasje në objekt
- 2 shenjëzimi i hapjes së derës
- toaletë i dedikuar për PAK
- 3 sporteli i dedikuar për PAK



BARRIERAT NË OBJEKTET PUBLIKE TË MALISHEVËS

ADMINISTRATA PUBLIKE - MALISHEVË



barriera fizike ekzistuese

- 1 qasje e vështirë nga shtegu për këmbësorë në objekt
- 2 gjerësia e shkëlësës së shkallëve më e vogël se 33 cm
- 3 lartësia e shkëlësës së shkallëve më e madhe se 15 cm
- 4 pragu i derës më i lartë se 2 cm
- 5 toaleta të papërshtatshme për PAK
- 6 sportel i papërshtatshëm për PAK
- 7 mungesë e elementeve për qasje në nivelet tjera të objektit

elemente që mungojnë

- parkingu i dedikuar për PAK
- fushat dhe vijat udhëheqëse taktore
- 1 ndryshim-theksimi i skajit të shkëlësës së shkallëve
- 2 pjerrina apo element lëvizës vertikal
- 3 gardhi anësor i shkallëve sipas UD
- 4 dorëza mbajtëse e shkallëve me krah më të gjerë se 250 cm sipas UD
- 5 ashensori apo mjet tjetër që siguron qasjen për PAK
- 6 shenjëzimi i hapjes së derës
- 7 shenjëzimi i qasjes së shkallëve
- toaleti i dedikuar për PAK
- sporteli i dedikuar për PAK



BARRIERAT NË OBJEKTET PUBLIKE TË MALISHEVËS

STACIONI POLICOR - MALISHEVË



barriera fizike ekzistuese

- qasje e vështirë nga shtegu për këmbësorë në objekt
- 1 gjerësia e shkëlësës së shkallëve më e vogël se 33 cm
- 2 lartësia e shkëlësës së shkallëve më e madhe se 15 cm
- 3 hapja e derës së hyrjes në anën e brendshme
- 4 toaleta të papërshtatshme për PAK
- 5 sportel i papërshtatshëm për PAK
- 6 mungesë e elementeve për qasje në nivelet tjera të objektit

elemente që mungojnë

- parkingu i dedikuar për PAK
- fushat dhe vijat udhëheqëse taktore
- 1 ndryshim-theksimi i skajit të shkëlësës së shkallëve
- 2 pjerrina apo element lëvizës vertikal
- 3 gardhi anësor i shkallëve sipas UD
- 4 dorëza mbajtëse e shkallëve me krah më të gjerë se 250 cm sipas UD
- 5 ashensori apo mjet tjetër që siguron qasjen për PAK
- 6 shenjëzimi i hapjes së derës
- 7 shenjëzimi i qasjes së shkallëve
- toaleti i dedikuar për PAK
- sporteli i dedikuar për PAK



BARRIERAT NË OBJEKTET PUBLIKE TË MALISHEVËS

GJIMNAZI "HAMDİ BERİSHA"




barriera fizike ekzistuese

- 1 qasje e vështirë nga shtegu për këmbësorë në objekt
- 2 pjerrinë me materializim jo adekuat dhe të dëmtuar
- 3 gjerësia e shkëlësës së shkallëve më e vogël se 33 cm
- 4 lartësia e shkëlësës së shkallëve më e madhe se 15 cm
- 5 pragu i derës më i lartë se 2 cm
- 6 toalete të papërshtatshme për PAK
- 7 mungesë e elementeve për qasje në nivelet tjera të objektit
- 8 hapja e derës së hyrjes në anën e brendshme
- 9 derë e klasës me hapësirë drite <90
- 10 pragu i derës së klasës më i lartë se 2 cm


elemente që mungojnë

- parkingu i dedikuar për PAK
- fushat dhe vijat udhëheqëse taktore
- 1 ndryshim-theksimi i skajit të shkëlësës së shkallëve
- 2 rrethoja e pjerrinës sipas UD
- 3 gardhi anësor i shkallëve sipas UD
- 4 derë hyrëse në klasë dhe mobiluar i përshtatur për kërkesat e PAK
- 5 ashensori apo mjet tjetër që siguron qasjen për PAK në lartësi mbi 120 cm
- 6 shenjzimi i hapjes së derës
- 7 shenjzimi i qasjes së shkallëve
- toaleti i dedikuar për PAK



BARRIERAT NË OBJEKTET PUBLIKE TË MALISHEVËS

SHKOLLA FILLORE "IBRAHIM MAZREKU"



barriera fizike ekzistuese

- 1 qasje e vështirë nga shtegu për këmbësorë në objekt
- 2 pjerrinë > 1:20 dhe pa rrethojë
- 3 gjerësia e shkelëses së shkallëve më e vogël se 33 cm
- 4 lartësia e shkelëses së shkallëve më e madhe se 15 cm
- 5 mungesë e elementeve për qasje në nivelet tjera të objektit
- 6 hapja e derës së hyrjes në anën e brendshme
- 7 derë e klasës me hapësirë drite <90
- 8 toalete të papërshtatshme për PAK

elemente që mungojnë

- parkingu i dedikuar për PAK
- fushat dhe vijat udhëheqëse taktore
- 1 ndryshim-theksimi i skajit të shkelëses së shkallëve
- 2 rrethoja e pjerrinës sipas UD
- 3 gardhi anësor i shkallëve sipas UD
- 4 dorëza mbajtëse e shkallëve me krah më të gjërë se 250 cm sipas UD
- mobiliar i përshtatur për kërkesat e PAK
- 5 ashensori apo mjet tjetër që siguron qasjen për PAK në lartësi mbi 120 cm
- 6 shenjëzimi i hapjes së derës
- 7 shenjëzimi i qasjes së shkallëve
- toaleti i dedikuar për PAK



BARRIERAT NË OBJEKTET PUBLIKE TË MALISHEVËS

QENDRA KRYESORE E MJEKSISË FAMILJARE




barriera fizike ekzistuese

- 1 qasje e vështirë nga shtegu për këmbësorë në objekt
- 2 pjerrinë > 1:20
- 3 gjerësia e shkelëses së shkallëve më e vogël se 33 cm
- 4 lartësia e shkelëses së shkallëve më e madhe se 15 cm
- 5 pragu i derës më i lartë se 2 cm
- 6 toalete të papërshtatshme për PAK
- 7 sportel i papërshtatshëm për PAK
- 8 mungesë e elementeve për qasje në nivelet tjera të objektit
- 8 hapja e derës së hyrjes në anën e brendshme

elemente që mungojnë

- 1 parkingu i dedikuar për PAK
- 2 fushat dhe vijat udhëheqëse taktore
- 2 ndryshim-theksimi i skajit të shkelëses së shkallëve
- 3 rrethoja e pjerrinës
- 4 gardhi anësor i shkallëve
- 5 ashensori apo mjet tjetër që siguron qasjen për PAK në lartësi mbi 120 cm
- 6 shenjëzimi i hapjes së derës
- 7 shenjëzimi i qasjes së shkallëve
- 8 toaleti i dedikuar për PAK
- 8 sporteli i dedikuar për PAK
- 8 dorëza mbajtëse e shkallëve me krah më të gjerë se 250 cm sipas UD



BARRIERAT NË OBJEKTET PUBLIKE TË MALISHEVËS

KEDS - DISKTRIKTI NË MALISHEVË



barriera fizike ekzistuese

- 1 qasje e vështirë nga shtegu për këmbësorë në objekt
- 2 de-nivelim në pllantonë hyrëse
- 3 lartësia e shkëlësës së shkallëve më e madhe se 15 cm
- 4 pragu i derës më i lartë se 2 cm
- toaleta të papërshtatshme për PAK
- 5 sportel i papërshtatshëm për PAK
- mungesë e elementeve për qasje në nivelet tjera të objektit
- 6 hapja e derës së hyrjes në anën e brendshme

elemente që mungojnë

- 1 parkungu i dedikuar për PAK
- fushat dhe vijat udhëheqëse taktore
- 2 ndryshim-theksimi i skajit të shkëlësës së shkallëve
- 3 pjerrina me rrethojë
- 4 dorëza mbajtëse e shkallëve me krah më të gjerë se 250 cm
- ashensori apo mjet tjetër që siguron qasjen për PAK në lartësi mbi 120 cm
- 5 shenjëzimi i hapjes së derës
- 6 shenjëzimi i qasjes së shkallëve
- toaleti i dedikuar për PAK
- sporteli i dedikuar për PAK




6

4

BARRIERAT NË OBJEKTET PUBLIKE TË MALISHEVËS

QENDRA PËR PUNË SOCIALE



barriera fizike ekzistuese

- 1 qasje e vështirë nga shtegu për këmbësorë në objekt - automjete të parkuara
- 2 gjerësia e shkëlësës së shkallëve më e vogël se 33 cm
- 3 lartësia e shkëlësës së shkallëve më e madhe se 15 cm
- 4 pragu i derës më i lartë se 2 cm
- 5 toalete të papërshtatshme për PAK
- 6 sportel i papërshtatshëm për PAK
- 6 mungesë e elementeve për qasje në nivelet tjera të objektit
- 7 hapja e derës së hyrjes në anën e brendshme


elemente që mungojnë

- 1 parkungu i dedikuar për PAK
- 1 fushat dhe vijat udhëheqëse taktore
- 2 ndryshim-theksimi i skajit të shkëlësës së shkallëve
- 3 gardhi anësor i shkallëve
- 4 ashensori apo mjet tjetër që siguron qasjen për PAK në lartësi mbi 120 cm
- 5 shenjzimi i hapjes së derës
- 6 shenjzimi i qasjes së shkallëve
- 6 toaleti i dedikuar për PAK
- 6 sporteli i dedikuar për PAK



BARRIERAT NË OBJEKTET PUBLIKE TË MALISHEVËS

BIBLOTEKA KOMUNALE



barriera fizike ekzistuese

- 1 qasje e pamundshme në objekt - objekti zhvillohet në etazhën III
- 2 gjerësia e shkëlësës së shkallëve më e vogël se 33 cm
- 3 lartësia e shkëlësës së shkallëve më e madhe se 15 cm
- 4 pragu i derës më i lartë se 2 cm
- toaleta të papërshtatshme për PAK
- 6 mungesë e elementeve për qasje në nivelet tjera të objektit
- 7 hapja e derës së hyrjes në anën e brendshme

elemente që mungojnë

- parkingu i dedikuar për PAK
- fushat dhe vijat udhëheqëse taktore
- 1 ndryshim-theksimi i skajit të shkëlësës së shkallëve
- 2 gardhi anësor i shkallëve sipas UD
- 3 ashensori apo mjet tjetër që siguron qasjen për PAK në lartësi mbi 120 cm
- 4 shenjëzimi i hapjes së derës
- 5 shenjëzimi i qasjes së shkallëve
- toaleti i dedikuar për PAK



3. Rekomandimet

3.1. Rekomandime të përgjithshme lidhur me eliminimin e barrierave në qasje dhe në lëvizje në qytezën e Malishevës

Bazuar në të gjeturat nga terreni, qyteza e Malishevës rrezulton të jetë e pa qasshme në tërësi për personat me aftësi të kufizuara, me theks në personat shfrytëzues të mjeteve ndihmëse dhe karrocës, personat e verbër dhe ata me shikim të dobësuar si dhe personat me dëgjim të vështirësuar.

Analizat e bëra në trajektoren e qendrës së qytezës së Malishevës dhe objekteve kryesore publike në këtë qytezë, flasin për nevojë imediate në intervenime konkrete për adaptimin e hapësirave dhe objekteve publike për nevoja të Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK). Bazuar në vizionin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-23, dhe në veçanti normave minimale të paracaktuara sipas Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara, rekomandimet e dalura nga ky hulumtim janë:

1. Të bëhet një studim vizibiliteti lidhur me adaptimin e qendrës së qytezës së Malishevës për nevoja të PAK, duke përfshirë këtu rrugët kryesore, rrugët lidhëse me objektet publike, parqet dhe hapësirat publike
2. Të bëhet një analizë e detajuar e mundësisë së adaptimit të objekteve publike për nevoja të PAK, duke përfshirë këtu objektet e administratës publike, objektet shkollore, objektet shëndetsore dhe objektet e tjera të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët
3. Të bëhet prioritizimi i intervenimeve në adaptimin e qendrës së qytezës së Malishevës dhe adaptimit të objekteve publike në politikat lokale
4. Të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i hapësirave të lartë-cekura, me qëllim të identifikimit të nevojave për intervenime shtesë në të ardhmen, varësisht nga zhvillimet në qytezë
5. Të bëhet shqyrtimi detaj i projekteve të reja të implementuara nga komuna apo palët e dyta në hapësirat dhe objektet publike duke u bazuar në normat minimale të paracaktuara sipas Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara
6. Të paracaktohen normat minimale të Udhëzimit Administrativ nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara si kusht themelor për procesin e pranimit teknik të ndërtimeve të reja
7. Të promovohet mundësia e qasjes së lirë në hapësirat e reviduara me qëllim të rritjes së numrit të personave me aftësi të kufizuara të cilët lëvizin lirshëm dhe bëjnë jetë të pavarur

Më konkretisht, ky hulumtim rekomandon që Drejtoria e Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike në Komunën e Malishevës duhet të prioritzoj adaptimin e trajektorës së qendrës së qytezës për nevoja të PAK, duke përfshirë këtu:

- dizajnimin dhe realizimin e shtegut të këmbësorëve me materializim sipas nevojave të PAK (materializim i një trajtshëm, pa de-nivelime dhe i mirëmbajtur)
- dizajnimin dhe realizimin e vendkalimeve sipas normave minimale të paracaktuara nga UD nr. 33/ 2007 (përfshirë pjerrinat, gurin skajor, pllakat taktore)
- dizajnimin dhe vendosja e semaforëve në vendkalime sipas normave minimale të paracaktuara nga UD nr. 33/ 2007 (përfshirë sinjalistikën zanore, arritshmërinë për personat në karrocë)
- dizajnimin dhe vendosjen e pllakave udhëheqëse taktore dhe pllakave taktore për sinjalizim të vendkalimeve dhe ndryshim-nivelit përgjatë trajektorës së qendrës së qytezës
- dizajnimin dhe vendosjen e pjerrinave sipas normave minimale të paracaktuara nga UD nr. 33/ 2007 përgjatë trajektorës së qendrës së qytezës, rrugëve lidhëse me objektet publike, parqet dhe hapësirat tjera publike
- dizajnimin dhe realizimin e parkingjeve të rezervuara për pak sipas normave minimale të paracaktuara nga UD nr. 33/ 2007 (përfshirë këtu sinjalizimin për parkingjet e dedikuara për pak, pjerrinën lidhëse me shtegun e këmbësorëve)

Ndërsa lidhur me gjendjen ekzistuese të objekteve publike në terren, barrierave të identifikuara dhe elementeve në mungesë të të cilave pamundësohet qasja e PAK, ky hulumtim rekomandon:

- dizajnimin dhe adaptimin e objekteve publike në funksion të arritjes së kushteve për përdorimin e mjeteve ndihmëse sipas normave minimale të paracaktuara nga UD nr. 33/ 2007 (përfshirë hapësirën e mjaftueshme lëvizëse për karroca, shkop, patericë, mjet ndihmës për ecje, shkop të bardhë dhe qen orientues)
- dizajnimin dhe vendosjen e elementeve obligative për qasje në të gjitha objektet publike sipas normave minimale të paracaktuara nga UD nr. 33/ 2007 përfshirë këtu pllakat taktore, rampat, shkallët, ashensori, platformat vertikale ngritëse, platformat vertikale palosëse)
- dizajnimin dhe vendosjen e elementeve qasëse për jetë të pavarur në të gjitha objektet publike sipas normave minimale të paracaktuara nga UD nr. 33/ 2007 (përfshirë këtu shkallët, hapësirat hyrëse, komunikimin, WC, mobiliari)



MBROJTËSE
KUFIZUESE

ISHULLI PËR
KËMBËSORË

UDHËKRYQI

VENDKALIMI I
KËMBËSORËVE

SHTEG ME HAPËSIRË TË
MJAFTUESHME PËR
PËRDORIMIN E SHKOPIT
TË B ARDHË DHE QENIT
ORIENTUES

SHTEG ME PLLAKA
TAKTORE

VENDPARKINGU

SHTEG ME HAPËSIRË TË
MJAFTUESHME PËR
LËVIZJE ME KARROCË








SHTEG ME HAPËSIRË TË
MJAFTUESHME PËR PËRDORIMIN
E MJETEVE NDIHMËSE

RRUGË TË RI-MATERIALIZUARA NË PËRSHTATSHMËRI PËR PAK

VENDKALIME TË RI-DIZAJNUARA DHE TË REALIZUARA SIPAS UD NR.33/2007


PLLAKA UDHËHQËSE TAKTORE PËRGJATË TRAJKTORES

APLIKIM I NORMAVE MINIMALE SIPAS UD NR.33/2007






ELEMENTET OBLIGATIVE PËR JETË TË PAVARUR - WC SIPAS UD 33/2007




1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14

ELEMENTET OBLIGATIVE PËR JETË TË PAVARUR - VENDPARKING SIPAS UD 33/2007




1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14

ELEMENTET OBLIGATIVE PËR QASJE - PLATFORMË VERTIKALE SIPAS UD 33/2007




7 8

ELEMENTET OBLIGATIVE PËR QASJE - SHKALLË SIPAS UD 33/2007




1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14

ELEMENTET OBLIGATIVE PËR JETË TË PAVARUR - MOBILIARI NË KLASË SIPAS UD 33/2007




9 10

ELEMENTET OBLIGATIVE PËR QASJE - RAMPË SIPAS UD 33/2007




1 2 3 4 5 6 9 10 11 12 13 14

ELEMENTET OBLIGATIVE PËR JETË TË PAVARUR - HAPËSIRA HYRËSE SIPAS UD 33/2007




1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14

ELEMENTET OBLIGATIVE PËR JETË TË PAVARUR - SPORTELI SIPAS UD 33/2007



1 2 3 4 5 6 7 8 11 12 13 14

ELEMENTET OBLIGATIVE PËR QASJE - ASHENSORI SIPAS UD 33/2007



1 2 3 4 5 7 8 9 10 11 12 13 14

SHENJËZIMI I OBJEKTEVE: 1. & 2. Komuna e Malishevës, 3.Gjykata, 4. Banka, 5. Posta, 6. Stacioni i autobusëve, 7. Administrata Publike, 8. Stacioni Policorë, 9. Shkolla Fillore "Ibrahim Mazreku", 10. Shkolla e Mesme – Gjinnazi "Hamdi Berisha", 11. Qendra Kryesore e Mjeksisë Familjare, 12. KEDS - Distrikti në Malishevë, 13. Qendra për Punë Sociale, 14. Bibloteka Komunale

ELEMENTET E REKOMANDUARA PËR DIZAJNIM DHE IMPLEMENTIM NË OBJEKTET PËRKATËSISHT TË LISTUARA

4. Referencat

1. *Convention on the Rights of Persons with Disabilities and Optional Protocol, United Nations*

<http://www.un.org/disabilities/documents/convention/convoptprot-e.pdf>

2. *Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2013 – 2023, Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit*

http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_NACIONALE_PER_TE_DREJTAT_E_PERSONAVE_ME_AFTESI_TE..._Shq+Ser+Ang.pdf

3. *Udhëzimi Administrativ Nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=7480>

4. *Harta e Barrierave - për qasjen dhe lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara, G.Gafurri, B.Vitija*

http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/161124111334_HARTA_E_BARRIERAVE___Raporti_final__edit_.pdf

5. *Ligji Nr. 04/L – 092 për Personat e Verbër, Kuvendi i Republikës së Kosovës*

<https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20personat%20e%20verber.pdf>

6. *Tipare të zhvillimit të popullsisë, Bekim Samadraxha, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Departamenti i Gjeografisë*

<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/02/Doktoratura-Bekim-Samadraxha-Fakulteti-i-Historise-dhe-i-Filologjise-Departamenti-i-Gjeografise.pdf>

7. *Municipal Profile - Malishevë, OSCE*

<https://www.osce.org/kosovo/13137?download=true>

